



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 703 Prot

Tiranë, më 29.03.2021

Nr. 1619 Dosje

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT (QKB – TIRANË)

Unë, Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 2098 (31134-07477-80) Regj, të lëshuar më datë 26.12.2019 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1619, Datë 04.03.2021 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqëria "Sevasti & Parashqevi Qirjazi" Sh.p.k (Universiteti Qirjazi), në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 182, datë 20.12.2018.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 534 Prot, Datë 05.03.2021 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 2098 (31134-07477-80) Regj, Datë 26.12.2019, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori Shoqëria "Sevasti & Parashqevi Qirjazi" Sh.p.k (Universiteti Qirjazi), ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit, dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër duke vënë sekuestër mbi aksionet te debitorit Shoqëria "Sevasti & Parashqevi Qirjazi" Sh.p.k (Universiteti Qirjazi), në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.



Për sa më sipër, në referim të Ligjit Nr. 26/2019, Datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat" si dhe Nenit 39 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative",

URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
 - a) Shoqëria "Sevasti & Parashqevi Qirjazi" Sh.p.k (Universiteti Qirjazi), me Nr. NIPT-i: K61830001Q,

Dhe
 - b) Z. Aleks Uldedaj (atësia: Gjokë, i datëlindjes: 24.01.1992) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "Sevasti & Parashqevi Qirjazi" Sh.p.k (Universiteti Qirjazi)

2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.

3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbartimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri

6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

